




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety	19-01-2024	4	viti god Year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIMSHEK	379/2024		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1470/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1470/2023 të datës 01.12.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me Nr.642 të datës 06.11.2023 të Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1470/2023 e datës 01.12.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.642 i datës 06.11.2023 i Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Plotësim dhe Ndryshimit të Kontratës me Nr. 179/2023 të datës 11.08.2023 në pozitën "Zyrtar Ligjor" në Qendrën Korrektuese në Lipjan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës,Udhëheqësja për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, më datë 06.11.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr.642 përmes të cilit ka shqiptuar masën e lehtë disiplinore "Vërejtje me Shkrim", me arsyetimin për shkelje të lehta disiplinore respektivisht mos protokollimin e një vendimi më datë 09.10.2023, po ashtu mos respektim të hierarkisë në kuptim që më datë 18.10.2023 ka përgatitur fletëslëshimin nga institucion për të burgosurin dhe e ka përcjell direkt tek drejtori i institucionit për aprovim pa më njoftuar fare dhe pa ju nënshtruar

*procedurës së kontrollit të dosjes paraprakisht nga ana ime si person përgjegjës ku këtë kompetencë dhe përgjegjësi e ka deleguar me vet iniciativë tek Mbikëqyrësi i Lartë për siguri si zyrtar jokompetent për këtë çështje, edhe përkundër emaileve zyrtar të datës 17.10.2023 mbi paralajmërimin rreth vërejtjeve ndaj tij i njëjti prapë ka vazhduar me avazin e vjetër, dhe me rastin e shkuarjes në pushim vjetor më datë 19.10.2023 i kam kërkuar me email zyrtar që ti bartë të gjitha informacionet që rrjedhin nga puna dhe përgjegjësia e tij i njëjti nuk ju ka përgjigj kërkesës duke mos ofruara asnjë informacion, po ashtu me datë 30.10.2023 përmes emailit zyrtar kam kërkuar deklaratë me shkrim por i njëjti nuk është përgjigjur.*

Ankuesi kundër këtij vendimi më datë 01.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7150.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 09.01.2024 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 1470/2023, e datës 01.12.2023, me numër protokollit 7150/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokollit 642, e datës 06.11.2023, i Udhëheqëses së Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; Deklaratë e datës 20.11.2023, e Deklaratë e datës 20.11.2023, e e-maili i datës 30.11.2023, dërguar nga Udhëheqëses për Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; Vendimi me numër protokollit 595, e datës 10.10.2023, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Institucionit; Plotësimi dhe ndryshimi i Akt Emërimit me numër protokollit 179/2023, i datës 11.08.2023; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Vendimi me numër protokollit 642, e datës 06.11.2023, i Udhëheqëses së Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; Deklaratë e datës 20.11.2023, e Deklaratë e datës 20.11.2023, e e-maili i datës 30.11.2023, dërguar nga e-maili i datës 30.11.2023, dërguara nga Udhëheqësja e Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; Vendimi me numër protokollit 595, e datës 10.10.2023, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Institucionit; Fletë Lëshimi me numër protokollit 119/2023, i datës 18.10.2023, për Lista e Kontrollueseve e datës 18.10.2023, për Vendimi me numër protokollit 545, e datës 10.10.2023; Fletë dorëzimi i datës 19.10.2023; e-maili i datës 17.11.2023, dërguar nga Udhëheqëses për Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; E-maili i datës 18.10.2023, dërguar nga e-maili i datës 30.10.2023, dërguar nga nga Udhëheqësja për Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme; Form për dorëzim pranimit datës 06.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 09.01.2024;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr.642 të datës 06.11.2023 të Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, pretendon se për shqiptimin e kësaj mase disiplinore nuk është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, ngase se lidhur me vendimin për formimin e komisionit ad-hoc mbikëqyrësja me datë 10.10.2023 më ka thënë verbalisht që të përgatis një

vendim të tillë dhe kur e kam dorëzuar te zyrtari i arkivës për protokoll data 09.10.2023 ka qenë e mbyllur dhe nuk ka mund të protokollohet me datë 09.10.2023; po ashtu pretendon se asnjëherë nuk i është kërkuar nga mbikëqyrësja të bëjë kontrollimin e listës së lirimeve ndërsa tutje pretendon se nuk ka mundur të përgjigjet në kërkesën e mbikëqyrëses për shkak që kur jam kthyer nga pushimi vjetor kam pasur shumë punë dhe jam i bindur që ju kam përgjigjur për të gjitha punët e kryera.

Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore për të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe konstaton se sipas këtij ligji të punësuarat/it e Shërbimit Korrektues janë nëpunës civil me status të veçantë, ku parashihet se: "1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës... paragrafi 2 Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin".

Në kuptim të vendosjes meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji i Këshillit mori për bazë: Nenin 55, i cili përcakton: "1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim", Nenin 56, që përcakton: "1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. nungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërmbyllja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbyllje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbylljen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimimi i dispozitave ligjore për përmbylljen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkakuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshelja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose nungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë

integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe :Nenin 58 ku përcaktohet se : “1. Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta. 2. Shkelje të lehta disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 2.1. është i pasjellshëm apo fyes në fjalë apo në vepra, ndaj te burgosurve, punonjësve tjerë dhe publikut, gjatë detyrës apo në rrethana që kanë të bëjnë me detyrat e tij; 2.2. angazhohet në aktivitete politike që ndikojnë negativisht në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të paanshme; 2.3. angazhon jashtë procedurës një të burgosur për të kryer ndonjë punë apo për të ofruar ndonjë shërbim pa marrë lejen nga mbikëqyrësi i tij; 2.4. mosmbajtja në mënyrë të rregullt të shkresave dhe të dhënave zyrtare që kanë lidhje me vendin e punës; 2.5. largim nga vendi i punës pa autorizim; 2.6. dy (2) mungesa të pa arsyeshme brenda vitit. 3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.1.vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 3.2. dëmtimi i pronës; 3.3 .ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 3.4. shkeljet serioze e rregullave të sigurisë; 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave koifidenciale; 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues, pa autorizim të Drejtorit Përgjithshëm; 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal; 3.8. jep informata për të burgosurit pa autorizim; 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuar apo vizitorit; 3.10. diskriminimi ne çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë; 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues; 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës; 3.13. me vetëdije apo me pakujdesi lëshon ose nënshkruan deklaratë të rremë në lidhje me përmbushjen e detyrës; 3.14. duke qenë përgjegjës, apo person me autoritet, injoron apo nuk ndërmerre masa kur një punonjës shkelë rregullat dhe detyrat e punës; 3.15. nuk i raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut; 3.16. nga pakujdesia rrezikon ose shkakton dëme fizike apo vdekjen e ndonjë te burgosurit punonjësi tjetër të Shërbimit apo personi tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi; 3.17. përdorë forcën e cila nuk është e kufizuar në intensitetin dhe zgjatjen e saj deri në atë masë që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim; 3.18. përdorë mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e Shërimit Korrektues; 3.19. lejon ose mundëson arratisjen e ndonjë të burgosuri; 3.20. nuk ndërmerre masat e duhura, që ka, kur ndonjë i burgosur shkelë rregulla e brendshme, sulmon një punëtor, të burgosur tjetër, ose anëtarë të publikut; 3.21. nuk jep llogari, mban pa vend, dhe keqpërdorë të hollat e pronën e publikut apo të hollat/pronën e çdo personi tjetër që i bien në dorë gjatë kryerjes së detyrës së tij; 3.22. flenë gjatë orarit të punës; 3.23. detyron, nxit apo përpiqet që me çdo kusht të detyrojë një punonjës tjetër të marrë pjesë në punë ilegale apo të palejuar, apo në shkeljen e standardeve të etikës profesionale; 3.24. nuk bën raportimin të menjëhershëm të një incidenti në institucion; Përlëshet me punëtorët tjerë të Shërbimit apo ndonjë anëtar tjetër të publikut gjatë detyrës; 3.25. fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sende të pa lejuara; 3.26. nuk raporton te zyrtarët kompetent, rastet e keqtrajtimit të të burgosurve nga ana e punëtorëve tjerë; 3.27. nuk raporton dhe nuk merr masa ndaj shkeljeve nga të burgosurit, konform dispozitave ligjore; 3.28. fsheh, mban, injoron, dëmton apo asgjëson ndonjë ankesë apo raport të bërë kundër ndonjë zyrtari ose te burgosuri; 3.29. keqpërdorimi i armës zyrtare apo humbja e saj”.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, ka konstatuar se Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit përmes emailit të datës 17.10.2023 të orës 10:16, ka kërkuar nga ankuesi

se për çdo kryerje të detyrave kur unë e shoh të nevojshme keni për obligim që të më përgjigjeni dhe të jepni llogari,. Andaj përpos përmbushjes së detyrave me përgjegjësi njëherit ju kërkoj dhe ju paralajmëroj që bisedën ta keni në nivelin profesional duke u bazuar vetëm në komunikim zyrtar... ndërsa përmes emailit të datës 17.10.2023 të orës 3:51:43 ka njoftuar ankuesin se: "siç jeni në dijeni keni kërkuar pushim vjetor të cilën kërkesë ju kam aprovuar, Pasi bartni një pozitë me rëndësi të veçantë në institucion deri tani nuk më keni përcjellur asnjë informacion lidhur me vazhdimin e përmbushjes së detyrave të tua gjatë kohës që do të qëndroni në pushim...ju njoftojmë që për çdo ngecje të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi tuaja gjatë kohës që qëndroni në pushim unë si mbikëqyrës e drejtpërdrejtë e juaja nuk bart asnjë përgjegjësi pasi nuk kam pranuar një informacion deri më tani", mirëpo ankuesi përmes emailit të datës 18.10.2023 ora 2:25 ka njoftuar mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë se: "ju njofton se unë do të shkoj në pushim vjetor nga data 19.10.2023 deri më 30.10.2023 sipas kërkesës suaj po ti dërgoj përshkrimin e detyrave të punës të Zyrtarit Ligjor për ti përkujtuar edhe pse si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e punës sime është dashur ti dish detyrat dhe përgjegjësit e kësaj pozitë me rëndësi të veçantë siç keni theksuar më poshtë. Deri më sot kur po të shkruaj i kam përmbushur të gjitha detyrat që janë kërkuar nga unë si: përpilimi i vendimeve të ndryshme, autorizimeve, vendimeve dhe lejeve për pushimin të të miturve në shtëpi, dërgimi i raporteve për PLK-në, Vlerësime dhe rivlerësime për pushim vjetor, raporte vlerësimi për punësim dhe transfere, pjesëmarrje në panele, kontrollimi i kutive të ankesave, kontrollimi i dosjeve, aktovendimeve/aktgjykimeve, llogaritja e dënimit dhe masës edukative, lirime të miturve nga QEKL, mbajtja e databazës e shumë punë tjera. Nga data 19.10.2023 nuk mbaj asnjë përgjegjësi për përmbushjen e detyrave të cilat kërkohej nga kjo pozitë gjatë kohës sa jam në pushim, nga data e lartcekur gjersa gjendem në pushim përgjegjësia bie mbi ty si udhëheqëse dhe mbikëqyrës e drejtpërdrejtë ta caktoni një zëvendësim ose ti bartësh vetëm këto përgjegjësi". Po ashtu nga provat e lëndës, rrjedh se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit përmes emailit të datës 30.10.2023 ora 2:57, ka kërkuar nga ankuesi një "deklaratë me shkrim lidhur me lirin e të miturit me Masë Edukuese më datës 18.10.2023 nga Qendra Edukuese Korrektuese pasi sipas fletlëshimit dhe listës kontrolluese janë bashkangjitur nga ana juaj, Ndërsa deklaratën e ka kërkuar për dy çështje: duke qenë në dijeni për përgjegjësit e juaja e keni përgatit këtë lirim nga institucioni pa më njoftuar fare mua si udhëheqëse e juaja dhe pa e dorëzuar tek unë në zyre dosjen e të burgosurit për kontroll dhe verifikim dhe me kompetencë të kujt e keni autorizuar që në vend timin ta kontrolloj dosjen dhe ta nënshkruar Mbikëqyrësi i lartë".

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh përshkrimin e detyrave të punës e që nënkuptohet se i njëjti i raporton Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan dhe sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht komunikimeve të cekura si më lartë, rezulton se ankuesi në kohën kur ka pasur të shkojë në pushim vjetor (nga data 19.10.2023 deri më datë 30.10.2023), nuk e ka njoftuar paraprakisht udhëheqësen e drejtpërdrejtë për punët dhe detyrat që kanë qenë në proces të kryerjes për këtë periudhë kohorë dhe këtë e ka bërë vetëm pasi që mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë ka kërkuar me Email që të njoftohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës, ankuesi lidhur me përgatitjen e flet lëshimit nga institucioni për të burgosurin nuk ka njoftuar mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë lidhur me këtë por këtë flet lëshim e ka përcjellë tek zëvendësuesi i Drejtorit të Institucionit, ndërsa listën kontrolluese e ka dërguar te mbikëqyrësi i lartë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se edhe pse ankuesit i është kërkuar nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë të jap një deklaratë me shkrim se cilat kanë qenë arsyet që ky dokumentacioni i lirit nuk është përcjell për shqyrtim tek ajo, mirëpo sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi nuk i është përgjigjur në kërkesën e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë, për më tepër në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës deklaroi se për shkak të grumbullimit të punës nuk ka pasur mundësi ti përgjigjet me shkrim mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë.

Bazuar nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë përshkrimin e detyrave të punës së pozitës së ankuesit, rezulton se ankuesi përmes veprimeve duke mos e njoftuar mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë për punët e tij dhe obligimet që i rrjedhin dhe duke mos i kthyer përgjigje në kërkesën e saj lidhur me deklaratën me shkrim të kërkuar, ka bërë shkelje disiplinore të parapara me nenin 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, kështu që duke marr parasysh këtë, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me Nr.642 i datës 06.11.2023 i Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan është nxjerr në pajtim me nenin 55 paragrafi 1, 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, nenin 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenin 58 paragrafi 1, nenin 61 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 dhe nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1470 /2023, datë 19/01/2024.

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.